SHOQERIA TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

# "R 21 " SHPK

DURRES – SHQIPERI

# AKT THEMELIMI

**Ne Durres**, sot me daten **18 Shkurt 2022**, une shtetasi

**Z.DARJO JASHARI**, atësia Ilir ,amësia Etleva, i datëlindjes 11.12.1996, lindur në Durrës dhe banues në Rr "Dervish Hima,Pallati Ambsador 3/Tiranë , Cel:0692031056, identitetin e të cilit e verifikova me *Pasaporte BE4362392 /J61211044A* me afat deri me datë 23.04.2025

,

bazuar ne:

* Vullnetin tim te lire, te plote, te sinqerte dhe ne inisiativen e lire private,
* Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
* Ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",
* Ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit"

Me anen e ketij **Akti Themelimi**, krijoj **Shoqerine tregtare ortak te vetem** dhe me pergjegjesi te kufizuar **"R 21 " Shpk – Durres.**

## NENI 1

Krijohet Shoqeria tregtare me emrin **"R 21"Shpk** emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

## NENI 2

**Selia Qendrore** e Shoqerise eshte ne adresen: Lagja 1,Rr. Tregtare, Pall.Fly,Kati Nr.II.

## NENI 3

Shoqeria shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me Vendim te Asamblese mund te krijohen ose anullohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise, apo ne ndonje shtet tjeter te huaj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise, si dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit, krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

**NENI 4**

**Kapitali Themeltar** i Shoqerise është neë likuditet në shumën .**1.000.000Lek** (nje milion lek) Lek i ndarë në **1 kuote** me vlere nominative **1 kuote/1.000.000Lek**, i formuar dhe nënshkruar nga unë Ortaku i vetëm **DARJO JASHARI.**

Ortaku ka pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjeter (te luajteshme apo te paluajteshme), te fituar ne rruge te ligjeshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Ortaku ka te drejte te transferoj jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht ose teresisht kontributin e tij, perfshire fondet dhe vlerat e kontributit ne natyre bazuar ne te drejten qe i njeh Ligji **"Per Investimet e Huaja"**.

**Shoqeria** dhe te tretet, respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

**NENI 5**

Me Vendim te Asamblese se Pergjithshme, ne dispozicion te Shoqerise mund te vihen fonde te tjera duke perfshire dhe shtesa me ane te kapitalit ne natyre

**NENI 6**

Ortaku ka te drejte, qe pas shlyerjes se detyrimeve ndaj te treteve, detyrimeve ligjore te Sistemit te taksave dhe atij fiskal te ruaj Fondin Rezerve.

**NENI 7**

**Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto Drejtime:**

**1.** Sigurimi fizik i objekteve shteterore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", i cili ushtrohet ne te gjithe territorin e vendit dhe jashte tij (me punonjes sherbimi, me pajisje sinjalizuese alarmi, me kamera sigurie, me badiguard, me qen, me kombinim te menyrave te mesiperme etj), "Sigurimi dhe shoqerimi i vlerave monetare e sendeve te çmuara gjate transportit", i cili ushtrohet ne te gjithe territorin e vendit dhe jashte tij. Importim, tregtim, instalim te mjeteve te sistemit vrojtues, sinjalizues, audoviziv, mjeteve te mbrojtjes kundra zjarrit, gazit, pajisjeve te nderlidhjes te teknikave te tjera te lejuara, projektim, instalim, dhe programimin e ketyre pajisjeve dhe sistemeve. Importim, tregtim, instalim, programim te pajisjeve te telekomunikacionit, radiokomunikacionit, radioalarmit dhe sistemeve te kontrollit dhe monitorimit ne distance te automjeteve. Sherbime te integruara sigurie per godinat, ne institucionet e arsimit parashkollor, shkollor, profesional dhe universitar dhe cdo godine Industriale, civile, ekonomike etj. Ofrimin e servisit per mirembajtje te sistemit te kamerave, sistemit te sinjal alarmeve, aparateve te sinjaleve, sistemit te nderlidhjes, radiodore etj. Blerje, shitje 2 dhe tregtim automjetesh te llojeve te ndryshme

**2.**Dhenje me qera ;ka te drejte te bashkepunoje me qellim fitimi ne ndermarje ose shoqeri te tjera te çfardo lloji,dpi dhe sido qe te jene krijuar ato;çdo lloj aktiviteti financiar ,tregetar,industrial ,ndertimi qe do te shihet ne interes te realizimit te objektit social te saj.

Shoqeria gjithashtu ka te drejte te japi hua ,financime per te tretet per shoqeri qe lidhen me te ose per shoqerite qe kontrollohen nga vete oratket.Mund te mare ndihma ose financime nga çfardo end publik ose privat ,shqipetar ose te huaj ,nga insitute bankare ose nga shoqeri qe lidhen me te ose qe kontrollohen nga ortaket.

**3**.Trasportim dhe tregetim me shumice dhe pakice per import dhe eksport te mallrave te ndryshme industrial.

**4**.Trasportim dhe tregetim me shumice e pakice per import -eksort te kimikateve te ndryshme, etjer.

**5**.Sherbime kontabiliteti. Sherbime per pergatitjen e pasqyrave financiare ose raporteve financiare. Sherbime per keshillime ne fushen e tatim taksave. Sherbime per keshillime financiare. Sherbime per keshillime ne raport me kuotat, aksionet apo tregtimin e tyre. Sherbime ne rolin e likuidatorit ne personat juridike. Sherbime si ekspert kontabiliteti ne proceset gjyqesore. Sherbime vleresimi te pasurish te paluajteshme. Sherbime si ekspert vleresues pasurish ne procese gjygjesore.

**6**.Sherbime konsulence ligjore dhe asistence per personat juridike dhe fizike ne fushen civile, penale, administrative, bankare, tregtare, rregullat e prokurimeve publike dhe koncensioneve. Konsulence dhe sherbime ne te drejtat e konsumatorit apo te drejtat e sigurimeve shoqerore, shendetsore apo te punesimit, te drejtat e emrit dhe te autorit. Mbrojtja e te drejtave me pasoje demshperblime ne fushen e sigurimeve dhe ne te gjitha format e demshperblimit si rrjedhoje e demit te shkaktuar. Konsulence dhe informacion biznesi, konsulence per shoqerite tregtare dhe OJF-te, konsulence ne fushen e liçensimit per te gjitha kategorite e ushtrimit te lire te profesionit. Konsulence e plote ne proçedurat ligjore te regjistrimit per kompani shqiptare dhe te huaja. Perfaqesim ligjor dhe asistence gjate proçedurave gjyqesore dhe te ekzekutimit te vendimve gjyqesore. Shoqeria mund te kryeje çdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi,si dhe mund te kryeje çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj.

## NENI 8

Me qellim arritjen e objektivit te shoqerise, shoqeria mund te merret me gjitheçka qe ka lidhje me objektin e saj, duke permbushur te gjitha veprimet tregtare, per pasurite e paluajteshme dhe te luajteshme, financiare e bankare, edhe me veprime te zbuluara (perjashtuar mbledhjen e fitimit), duke pranuar pjesemarrjen ne fitim si dhe marrjen pjese ne shoqeri te tjera dhe sipermarrje me objekt veprimtarie analog, te ngjashem ose te lidhur me te, qofte direkt, qofte indirekt.

**NENI 9**

Me Vendim te Asamblese, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqipetar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjeter tregetare si brenda vendit dhe jashte shtetit, te zgjeroj Objektin e veprimtarise se saj, te ndahet ne mirekuptim mes ortakeve ose ne rruge gjyqesore etj.

**NENI 10**

Organi me i larte Drejtues dhe i vetem Vendimor i Shoqerise eshte Mbledhja Asamblese se Pergjithshme e cila ushtron te gjitha kompetencat qe i njeh **Ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare".**

Ortaku mund t'ja delegoj kompetencat e tij nje ose me shume Administratoreve te caktuar me vendim te Asamblese ose dhe nje personi fizik shtetas shqipetar apo i huaj, mbi bazen e **Prokures te bere me akt noterial**.

**NENI 11**

Me Vendim me shkrim te Asamblese caktohet, shkarkohet **Administratori Pergjithshem** brenda ose jashte bashkesise se Ortakerise si dhe **Eksperti Kontabel i Autorizuar**.

**NENI 12**

**Administrator i Pergjithshem** i Shoqerise, emerohet ortaku **DARJO JASHARI** , i cili bazuar ne **nenin 95 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008** "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

**NENI 13**

Detajimi ne lidhje me problemet dhe administrimin e Kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative te tij, Transferimi, zmadhimi ose zvogelimi i Kapitalit, menyra e Drejtimit Administrativ te Shoqerise, ajo e mbajtjes se llogarive dhe te Bilancit financiar, zgjerimi i Shoqerise ose shnderimi i saj ne nje forme tjeter Shoqerie Tregtare, bashkimi me Shoqeri te tjera tregetare vendase apo te Huaja, ndarja apo menyrat e falimentimit te saj dhe kalimit ne Likuidim etj, percaktohen ne menyre me te specifikuar ne Statutin e Shoqerise qe i bashkelidhet ketij Akti Themelimi.

**NENI 14**

Si rregull dhe pergjithsisht Ortaku drejton dhe zhvillon aktivitetin tregetar te Shoqerise mbi bazen e mirekuptimit profesional dhe ligjor.

**NENI 15**

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 3 (tre)ekzemplare ne gjuhen **shqipe**, me permbajtje e vlera te njenjta juridike dhe pasi lexohet me ze, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i Shoqerise tregetare me ortakeri" **R 21** " **Shpk**, nenshkruhet prej tij ne te gjitha ekzemplaret duke vene emri, mbiemri dhe firmat origjinale.

**ORTAKU VETEM THEMELUES**

**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**" R 21 "Sh. p. k.**

**Miratues i ketij Akti Themelimi**

*Shtetasi shqipetar*

Z.________________________